



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti
Mbledhja nr. 142/2024
Prishtinë, më 24.9.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramoz Agusholli, Abelard Tahiri, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Të ftuar: Habib Basholli, kryetar i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM.

Pjesëmarrës tjerë: Bahri Karaça dhe Nasuf Mjekiqi, anëtar të Bordit të KPMM-së, Naim Sejdiu, Sali Mulaj, Haradin Gërvalla dhe Mentor Sylmeta, KPMM; Sami Gashi, Salih Hoxha, GP LVV; Duresa Tafa, Kuvend, Egzon Dahsyla – Kallxo.com, dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 19.9.2024;**
- 3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor për vitin 2024;**
- 4. Vazhdimi i shqyrtimit të Raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.a. për vitin 2023;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2023;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që nga rendi i ditës, të largohet pika 4., dhe në vend të saj, të futet në rend dite: “Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-295 për Kripto-asetet”, sepse kemi një konsultim.

Rendi i ditës u miratua me këto ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 19.9.2024

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më datë 19.9.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor për vitin 2024

Kryetari, tha se draftin e planit të punës e kemi marrë, i cili është hartuar nga stafi i Komisionit, mbështetur në programin legjislativ të qeverisë (i ndryshuar dhe i plotësuar), aktivitetet e bartura nga sesioni pranveror dhe lëndët tjera në procedurë.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, miratoi Planin e punës për sesionin vjeshtor të këtij viti - 2024.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-295 për Kripto-asetet

Kryetari, tha se në mbledhjen e fundit (19.9), e proceduam për lexim të dytë këtë projektligj, por stafi i Komisionit është kontaktuar nga NJIF (Njësia e Inteligjencës Financiare), ku kanë kërkuar të bëhet vetëm një ndërhyrje teknike te një amendament. Ndërhyrja bëhet me qëllim të evitimit të kolizionit të referencave në dispozitat e Projektligjit për kripto-asete dhe legjislacionit në fuqi, të amendamenti 11, paragrafi 3, mungon fjala “BQK” (Banka Qendrore e Kosovës). Ky propozim paraqitet, bazuar në faktin se në kuadër të Ligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, për subjektet raportuese të licencuara nga BQK, të dy autoritetet kanë kompetenca të ndara sa i përket mbikëqyrjes së pajtueshmërisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (shih neni 34 të Ligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit).

Pra, kjo ndërhyrje është teknike, andaj amendamenti 11, i propozuar për ndryshim, është si vijon:
3. NjIF-K dhe BQK janë autoritete kompetente për inspektimin dhe mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së operatorëve të përcaktuara sipas këtij ligji, bazuar në dispozitat e Ligjit përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, VENDOSI:

- 1. Tërhiqet Raporti me rekomandime për lexim të dytë i Projektligjit nr.08/L-295 për Kripto-asetet, i proceduar më datë 19.9.2024;*
- 2. Procedohet Raporti me rekomandime për lexim të dytë i Projektligjit nr.08/L-295 për Kripto-asetet, me plotësimin teknik të amendamentit 11.*

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2023

Kryetari, tha se në bazë të nenit 58 të Ligjit nr.03/L-163, për minierat dhe mineralet, KPMM-ja raporton në Kuvendi për raport vjetor. Nga stafi e keni marrë një memo, me të cilin keni një analizë dhe disa pyetje lidhur me këtë raport vjetor. Për ta prezantuar raportin ia kaloj fjalën kryesuesit të bordit ,z. Habib Basholli dhe mandej hapim debat.

Habib Basholli, kryesues i Bordit në KPMM, kërkoi që t'i kalohet fjala drejtorit të përgjithshëm të KPMM-së, me arsyetimin se mandatin ky bord e ka marrë këtë vit (2024).

Kryetari, tha se nuk ka të drejtë një ushtrues detyre, i cili është më tepër se dy vite në këtë pozitë dhe si rrjedhojë është jashtëligjshëm në këtë pozicion. Ai tha se edhe vendimet e tij janë të jashtëligjshme dhe në Komision nuk mund të raportojë dikush që nuk i plotëson kriteret ligjore.

Habib Basholli, kryesues i Bordit në KPMM, tha se nuk pranon të raportojë për periudhën në të cilën nuk ka qenë i ngarkuar me punë në KPMM.

Mimoza Kusari – Lila, propozoi të shtyhet takimi për një mbledhje tjetër dhe të përgatitet bordi aktual, për të raportuar për punën e vitit 2023 në KPMM.

Armend Muja, propozoi që përveç raportimit për vitin 2023, bordi duhet të përgatitet të raportojë edhe për vitin 2022, dhe këtë vit, pasi që kanë marrë detyrën (2024).

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se nuk do të ndryshojë asgjë, nëse do të shtyhet raportimi për një mbledhje tjetër dhe tha se është mirë të kryhet sot raportimi për punën e vitit 2023.

Jeta Statovci, tha se bordi aktual e ka për detyrë të raportojë për punën e vitit 2023, edhe pse në atë kohë ka qenë dikush tjetër në bord, por nuk është përgjegjës për vendimet e bordit të kaluar.

Pal Lekaj, tha se bordi aktual nuk mund të mbajë përgjegjësi për periudhën kur këta nuk kanë udhëhequr këtë bord, por këta duhet të raportojnë para këtij Komisioni.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, VENDOSI që në mbledhjen e ardhshme, Bordi aktual i KPMM-së do të ftohet që të raportojë për punën e vitit 2022, 2023 dhe këtë vit (2024).

5. Të ndryshme Çështjet vijuese

Kryetari, në lidhje me konkursin për plotësimin e tri pozitave në Bordin e KOSTT-it, u vendos që Komisioni (paneli), të mblidhet më datë 26.9.2024, që t'i shqyrtojë aplikacionet.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit